



United Nations
Educational, Scientific and
Cultural Organization

Organisation
des Nations Unies
pour l'éducation,
la science et la culture

Organización
de las Naciones Unidas
para la Educación,
la Ciencia y la Cultura

Организация
Объединенных Наций по
вопросам образования,
науки и культуры

منظمة الأمم المتحدة
للتربية والعلم والثقافة

联合国教育、
科学及文化组织



Divizioni i Ekologjisë dhe Shkencave të Tokës Programi Njeriu dhe Biosfera (MAB)

Znj. Venera Domi
Sekretare e Përgjithshme
Drejtoare e Organizatave
Ndërkombëtare
Drejtoria e Përgjithshme e
Marrëdhënieve Shumëpalëshe
Ministria e Punëve të Jashtme,
Bulevard Gjergj Fishta, 6
Tiranë,
Shqipëri

Ref: SC/EES/MB/14/5864/501

16 Korrik 2014

E nderuar Znj. Domi,

Kam kënaqësinë e madhe t'ju informoj lidhur me vendimin e Këshillit Ndërkombëtar Koordinues të Programit Njeriu dhe Biosfera (MAB) të UNESCO-s për miratimin e **Rezervës Ndërkufitare të Biosferës Ohër-Prespë (Republika e Shqipërisë / Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë)** të propozuar nga vendi juaj .

Këshilli arriti në këtë vendim në sesionin e tij të 26 që u mbajt në Rezervën e Biosferës East Vättern Landscape në Jönköping, Suedi, nga 10 deri më 13 Qershor.

Këshilli, bazuar në rekomandimet e Komitetit Këshillimor Ndërkombëtar për rezervat e biosferës dhe Zyra MAB, bëri rekomandimet e mëposhtme:

Këshilli mirëpriti këtë propozim për një rezerve ndërkufitare biosfere (RNB) nga Shqipëria dhe ish Republika Jugosllave e Maqedonisë në rajonin e Ohrit dhe Prespës. Peizazhi i zonës së propozuar ndërkufitare është një kombinim i sipërfaqeve ujore (liqenet e Ohrit dhe Prespës) dhe i relievave malore përreth ndërsa pjesët e rrafshëta kufizohen me kufijtë e jashtëm të territorit (Shqipërisë, ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë dhe Greqisë). Zona e propozuar, me një sipërfaqe të përgjithshme prej 446.244 ha dhe me një popullsi prej 455,000 banorë, përfshin një pjesë të liqenit të Ohrit dhe territorit përreth tij në ish Republikën Jugosllave e

Maqedonisë, që është regjistruar aktualisht në Listën e Trashëgimisë Botërore, si dhe pjesën e liqenit Ohrit në Shqipëri e cila është duke u konsideruar si zgjerim i mundshëm i trashëgimisë ekzistuese natyrore dhe kulturore të rajonit të Ohrit si vend i Trashëgimisë Botërore.

Këshilli u njoh me përfshirjen e fortë të institucioneve lokale gjatë proces nominimit dhe përshëndeti planin për të krijuar një platformë për shkëmbimin e eksperiencave të zonave të mbrojtura në mes të ekspertëve, praktikantëve dhe popullatës lokale.

Këshilli vlerësoi vendimin e miratuar të qasjes me dy faza në procesin e nominimit të rezervës ndërkufitare të biosferës, "duke lënë dyert e hapura" për Greqinë për t'u bashkuar sa më shpejt kur të jetë e përshtatshme për të.

Këshilli miratoi këtë nominim si fazë e parë e Rezervës Ndërkufitare të Biosferës, dhe inkurajon për të vazhduar më tej dialogun me Greqinë, në mënyrë që të merret në konsideratë si një fazë e dytë e RNB baseni mes tre vendeve, si qasje e pellgut ujëmbledhës dhe e menaxhimit të ekosistemeve nga e cila do të përfitonin të gjitha vendet që ndajnë këtë ekosistem duke kooperuar dhe punuar së bashku.

Unë do të jem mirënjohës nëse ju mund të transmetoni këto komente dhe përgëzimet tona tek autoritetet e interesuara.

UNESCO, së bashku me urimet e Këshillit MAB, i jep çdo rezerve të re biosfere certifikatën e nënshkruar nga Drejtori i Përgjithshëm i UNESCO-s, të cilën vendi mund të dëshirojë ta riprodhojë në formën e një pllake në zonën në fjalë. Unë do t'ju isha mirënjohës nëse do të më informoni në kohën e duhur për planin tuaj në lidhje me festën e inaugurimit apo ceremoninë që do të organizohet për këtë Rezervë ndërkufitare Biosfere.

Raporti i plotë i sesionit të 26 të Këshillit Ndërkombëtar Koordinues të MAB gjendet në websitin UNESCO-MAB në:

<http://www.unesco.org/new/en/natural-sciences/environment/ecological-sciences/man-and-biosphere-programme/about-mab/icc/icc/26th-session-of-the-mab-council/>

Unë ju falënderoj juve për mbështetjen e vazhdueshme të Programit MAB dhe të Rrjetit Botëror të Rezervave të Biosferës, që tani përbëhet nga 631 rezerva biosfere në 119 vende.

Sinqerisht i juaji

Han Qunli

Drejtor, Divizioni i Ekologjisë dhe Shkencave të Tokës

Sekretar i Programit Njeriu dhe Biosfera (MAB)

cc.: Delegacionit të Përhershëm të Shqipërisë në UNESCO